



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

Data .04.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pjesë këmbimi IT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,189,306 (Nente milione e njeqind e tetedhjetë e nente mijë e treqind e gjashtë) leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Autoriteti Portual Durrës**”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, dhe në nenin 43 pika 2.a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të të ardhurat", i ndryshuar, neni 29 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kapaciteti teknik:

2.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit të kontratës së shpallur, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe **nenin 40, pika 4** dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardet ISO si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalent), për menaxhimin e cilësisë
- ISO 27001:2022 (ose ekuivalent), për menaxhimin e sigurisë së informacionit

Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga operatore të njohur nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, t'i bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

2.3 Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë
pë Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë:

37 – *Bord Elektronik Barriere*

39 – *Elektromotorr Barriere*

40- *Sensor Finekorse Barriere*

96- *DVR Motec Modeli MBE5201-1*

Argumentimi

Nisur nga rëndësia e veçantë e këtyre 4 zërave dhe nga fakti që këto zëra duhet të integrohen 100% në një sistem ekzistues jo vetëm si pajisje por edhe të jenë kompatibël me sistemin e menaxhimit të trarëve elektronikë justifikohet kërkitimi i mostrave të këtyre produkteve specifikisht.

Bordi Elektronik për Barrierë kërkohet si mostër pasi përbën komponentin qendror të kontrollit të barrierës automatike. Duke qenë se pajisja do të përdoret në ambiente të jashtme dhe ekspozuar ndaj faktorëve si lagështia, temperaturat e larta/ulëta dhe ndërhyrjet e mundshme elektrike, është e nevojshme të verifikohet në mënyrë praktike përputhshmëria e saj me sistemin ekzistues të kontrollit të aksesit, si dhe stabiliteti i funksionit të saj në kushte operative. Gjithashtu, duhet të vlerësohet cilësia e ndërtimit, tipologjia e lidhjeve elektrike dhe mundësia për mirëmbajtje teknike. Mostra është thelbësore për të siguruar që bordi përmbush kërkesat teknike përpara miratimit për përdorim në masë, në përputhje me të drejtën e autoritetit kontraktor për të kryer vlerësime teknike.

Elektromotori për barrierë kërkohet si mostër pasi është elementi lëvizës kryesor i barrierës dhe ndikon drejtpërdrejt në performancën e saj mekanike. Kjo pajisje do të operojë në kushte të vazhdueshme pune dhe mund të përballë me ngarkesa të larta, lëvizje të shpeshta, si dhe ndryshime të menjëhershme në tension elektrik. Mostra është e nevojshme për të testuar fuqinë dhe momentin rrotullues të motorit, kapacitetin për funksionim të qëndrueshëm, si dhe përshtatshmërinë me pjesët e tjera mekanike të barrierës ekzistuese. Gjithashtu, duhet të verifikohet ndërtimi fizik dhe niveli i mbrojtjes ndaj pluhurit dhe ujit (IP). Kjo lejon autoritetin kontraktor të sigurohet se pajisja përmbush kriteret teknike dhe funksionale përpara miratimit për furnizim të plotë.

Sensori Finekorse për barrierë kërkohet si mostër pasi përbën një element sigurie kritik në funksionimin e barrierës automatike. Ai do të përdoret në ambiente të jashtme, me ekspozim ndaj kushteve atmosferike dhe ndërhyrjeve të mundshme elektromagnetike. Kërkohet të vlerësohet

në mënyrë praktike ndjeshmëria e sensorit, distanca e detektimit, reagimi në kohë reale dhe përputhshmëria me sistemin e kontrollit të barrierës. Gjithashtu, është e rëndësishme të verifikohet nëse sensori ka certifikime të duhura për përdorim në sisteme sigurie dhe nëse ofron qëndrueshmëri në kushte industriale. Mostra është thelbësore për të garantuar që pajisja plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, në përputhje me të drejtën e autoritetit kontraktor për të kryer vlerësim të detajuar teknik përpara aprovimit.

Pajisja DVR Motec Modeli MBE5201-1 kërkohet si mostër pasi do të përdoret në struktura të lëvizshme si Vinçat portuale, ku ambienti operacional përfshin vibrime të vazhdueshme, ekspozim ndaj faktorëve atmosferikë dhe kushte të vështira teknike. Kërkohet të verifikohet në mënyrë praktike përputhshmëria e pajisjes me sistemin ekzistues të transmetimit video, performanca e regjistrimit në kohë reale, si dhe qëndrueshmëria e saj në kushte industriale. Mostra është thelbësore për të garantuar që pajisja përmbush kërkesat teknike, përpara miratimit për përdorim në shkallë të gjerë, në përputhje me të drejtën e autoritetit kontraktor për të kryer vlerësime teknike.

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4 Operoret ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.
- Adresa dhe web-siti të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës të shënuar me një shenjë dalluese.

2.5 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

ARGUMENTIM MBI MARRËVESHJEN KUADËR :

1.Marrëveshja kuadër do të lidhet me një operator ekonomik, pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të tilla si: lista e artikujve, specifikimet teknike, si dhe sasi të që pritet të furnizohen.

2. Nga përvoja e prokurimit të artikujve (objekt i kësaj procedure) në vite, çmimet e tregut kanë rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe nuk ndryshojnë.

3. Në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, duke parë edhe natyrën e këtyre mallrave që përgjigjen nevojave imediate të AK kjo mund t'i shkaktonte kosto shtesë, pasiguri, dhe vështirësi autoritetit kontraktor, si p.sh. mospërputhje të artikujve të dhënë në bazë të rendit, pjesë të tyre të përbashkëta.

Afati i marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të saj.

GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA

Produktet e furnizuara, **duhet të jene te reja** si dhe te kenë një garanci përdorimi, sipas skedave teknike të përcaktuara në dokumentin “Specifikimet Teknike”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Komisioni: